



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 30 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Haling

Valeria Boliçi

Xhejms Pejs

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli



TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 shtator 2021, pas parashtrimeve të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt ("Mbrojtja e Haradinajt"), Trupi Gjykses e urdhëroi Mbrojtjen e tij të dorëzonte aktekspertizën e dëshmitarit ekspert që kishte propozuar – konkretisht Dëshmitarin 17 në listën paraprake të dëshmitarëve të Mbrojtjes – deri më 1 tetor 2021.¹
2. Më 30 shtator 2021, Mbrojtja e Haradinajt paraqiti një kërkesë me anë të së cilës kërkonte shtyrjen me dy javë të afatit për dorëzimin e aktekspertizës së Dëshmitarit 17 ("Kërkesa").² Në të njëjtën ditë, Mbrojtja e Hysni Gucatit ("Mbrojtja e Gucatit") paraqiti mocion për t'iu bashkuar Kërkesës ("Mocioni për Bashkim").³

II. PARASHTRIME

3. Mbrojtja e Haradinajt kërkon dy javë shtesë për të dorëzuar aktekspertizën e Dëshmitarit 17.⁴

¹ Urdhër Gojor për Caktimin e Afatit për Paraqitjen e Aktekspertizës së Mbrojtjes, 2 shtator 2021, f. 603, rreshtat 13-16.

² F00339, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit* ("Kërkesa"), 30 shtator 2021.

³ F00340, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Bashkim me Kërkesën për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin e Provave të Ekspertit* KSC-BC-2020-07-F00339, 30 shtator 2021.

⁴ Kërkesa, para. 6, 12.



III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

4. Sipas rregullës 9(5) të Rregullores, Trupi Gjykses mund ta zgjasë afatin e përcaktuar nga ai vetë, kur i paraqiten arsye të vlefshme.
5. Sipas rregullës 9(6) të Rregullores, përveç se kur Trupi Gjykses ka urdhëruar ndryshe, dhe kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve, kur është e zbatueshme, mund të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.

IV. DISKUTIM

6. Trupi Gjykses gjykon se rrethanat personale të paparashikueshme dhe bindëse që përshkruan Kërkesa për sa i përket Dëshmitarit 17, justifikojnë shtyrjen e afatit. Gjithashtu, Trupi Gjykses gjykon se kohëzgjatja e shtyrjes që kërkohet është e arsyeshme dhe nuk vonon procesin në mënyrë të panevojshme. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses arrin në përfundimin se janë demonstruar arsye të vlefshme që justifikojnë shtyrjen e kërkuar të afatit.
7. Për më tepër, duke qenë se vonesa e kërkuar nuk e vonon në mënyrë të panevojshme procesin dhe nuk ndikon në paraqitjen e provave nga ana e ZPS-së, Trupi Gjykses gjykon se mund të marrë vendim lidhur me Kërkesën pa i dhënë mundësi ZPS-së të shprehë mendimin e vet.
8. Trupi Gjykses i përmbahet urdhrit të tij që ZPS-ja të dorëzojë njoftim lidhur me aktekspertizën siç përcaktohet në rregullën 149(2) të Rregullores, brenda shtatë (7) ditësh nga momenti i nxjerrjes së aktekspertizës.⁵

⁵ Urdhër Gojor për Caktimin e Afatit për Paraqitjen e Aktekspertizës së Mbrojtjes, 2 shtator 2021, f. 603, rreshtat 18-19.



V. KLASIFIKIMI

9. Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja i ka parashtruar mocionet e saj në mënyrë konfidenciale. Trupi Gjykses e urdhëron Mbrojtjen e Haradinajt që të dorëzojë një version publik të redaktuar të Kërkesës, duke fshirë informacionin personal lidhur me Dëshmitarin 17. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se Mocioni për Bashkim nuk përmban ndonjë informacion konfidencial dhe, për këtë arsye, i kërkon Administratores që ta riklasifikojë si publik.

VI. VENDIM

10. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** Kërkesën;
- b. **URDHËRON** Mbrojtjen e Haradinajt që, deri më **15 tetor 2021**, të dorëzojë aktekspertizën e Dëshmitarit 17;
- c. **URDHËRON** ZPS-në që, sipas rregullës 149(2) të Rregullores, të dorëzojë një njoftim lidhur me aktekspertizën, brenda shtatë (7) ditësh nga momenti i nxjerrjes së saj;
- d. **URDHËRON** Mbrojtjen e Haradinajt që, deri më **8 tetor 2021**, të dorëzojë një version publik të redaktuar të Kërkesës, sipas paragrafit 9; dhe
- e. **I KËRKON** Administratores që Mocionin për Bashkim (F00340) ta riklasifikojë si publik sapo të jetë dorëzuar version publik i redaktuar i Kërkesës.



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III
Kryegjykatës

E enjte, 30 shtator 2021

Hagë, Holandë